

**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE**

**“YOUTH TALK”**

**Editorial nga bashkëbisedimi i të rinjve me drejtorin e Administratës në Prizren, Osman Hajdari**

Hollësitë mbi funksionimin e administratës komunale dhe për proceset vendimmarrëse lokale janë shpalosur para të rinjve nga drejtori i Administratës në Komunën e Prizrenit, Osman Hajdari, në kuadër të “Youth Talk” të mbajtur me 26 shkurt 2021 në Prizren.

Në këtë takim, Hajdari fillimisht ka shpjeguar sfidat me të cilat është përballur gjatë mandatit aktual qeverisës, duke shtuar se pritjet e qytetarëve kanë qenë të mëdha.

Para të rinjve të rajonit të Prizrenit ai ka ndarë përvojën për jetësimin e projektit të Qendrës së Shërbimeve me një ndalesë, që sipas tij është pjesë e procesit të reformës administrative në këtë komunë. Hajdari ka theksuar se zbatimi i reformave nuk ka qenë i lehtë, pasi që edhe vet punonjësit e komunës kanë qenë të papërgatitur për një gjë të tillë. Megjithatë ka pohuar se vështirësitë janë tejkaluar hap pas hapi, pasi gjatë procesit janë krijuar kushte më të mira edhe për stafin e Komunës.

Pjesëmarrësit e “Youth Talk” kanë adresuar pyetje mbi mënyrat e eliminimit të korrupsionit gjatë ofrimit të shërbimeve për qytetarët e Komunës së Prizrenit, pastaj për rritjen e efikasitetit të organeve komunale për përfshirjen më të madhe të rinjve në proceset vendimmarrëse lokale, bashkë me shtimin e llogaridhënies nga zyrrarët lokalë si dhe tema të tjera nga përditshmëria e tyre, që ndërlidhen me shërbimet që ofrohen nga Komuna.

Gjatë diskutimit ndërveprues Hajdari ka paraqitur përvojat mbi mënyrat e menaxhimit të situatave të ndjeshme, siç është luftimi i korrupsionit. Ai ka treguar se si Komuna e Prizrenit ka zhvilluar procedura që nuk kanë pas bazë ligjore dhe të cilat kanë rrezikuar autoritetin e Komunës. Sipas tij në kuadër të reformës administrative janë ndërmarrë veprime për thjeshtimin e procedurave administrative, largimin e procedurave pa bazë ligjore dhe shërbimet që nuk i takojnë autoritetit të Komunës.

Zyrtari i lartë komunal ka bërë të ditur se si roli i Komunës parashihet të jetë rregullator i marrëdhënieve në komunitet, gjë që sipas tij në të shkuarën nuk është zbatuar në mënyrën e duhur nga Komuna dhe se shpesh herë është bërë pjesë e problemit dhe jo zgjidhje e tij. Këto praktika dhe anshmëria e Komunës sipas tij kanë bërë që qytetarët të humbin besimin në këtë institucion, gjë që është manifestuar me transparencë minimale, korrupsion apo mitmarrje në shkallë të vogël dhe burokraci të tepërt.

Mirëpo Hajdari ka shfaqur besimin se reforma administrative ka hequr privilegjet për stafin dhe se qytetarët i ka bërë palë të barabartë, në mënyrë që ta kthej besimin e tyre në instiucion. Por ka pranuar se Komuna nuk ka bërë mjaftueshëm për sensibilizimin e të rinjve për pjesëmarrje në proceset vendimmarëse lokale. Hajdari ka inkurajuar të rinjtë që të jenë aktiv edhe kritik të qeverisjes komunale, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve në raport me këtë kategori të shoqërisë. Njëherësh ka paraqitur edhe idenë e Kartës së Vullnetarit, me qëllim të nxitjes së angazhimit vullnetar të rinjve në këtë komunë dhe aktivizimit të tyre në aktivitetet me interes publik.

“Youth Talk” në Prizren është organizuar në kuadër të projektit “Rritja e qasjes në drejtësi në nivel komunal” me mbështetje të YIHR KS, financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit (INL) dhe implementuar nga EC Ma Ndryshe.

“Ky editorial është mundësuar me mbështetjen e YIHR KS dhe financuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan (INL). Përmbajtja e këtij editoriali është përgjegjësi e plotë e Ec Ma Ndryshe dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e INL apo YIHR KS”